

VENDIM
Nr.677, datë 21.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA RUZHDIË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Ruzhdië të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 10 (dhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Ruzhdië për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVË

Komuna: **Ruzhdie**

Fusha e përdorimit të pronës: pyll

Nr. ren	Nr. inv. sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullusore (E.P.K)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip.në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	29	Ek.P. Drenie	Faqe kories	16/a	shkurre	23	prodhues	MMPAU	D.Sh.P.Fier	
2	31	"	M.cuk banushit	17	shkurre	40	"	"	"	
3	32	"	Qafa Cajkes	18/b	shkurre	7.5	"	"	"	
4	33	"	F.sheshit ullishtes	19	shkurre	34	"	"	"	
5	34	"	Kuota 396 506	20	shkurre	26	"	"	"	
6	35	"	F.lumit te vjeter	21/a	shkurre	37.5	"	"	"	
7	37	"	bregu patres	22	shkurre	9	"	"	"	
8	38	"	F.rez.siqeca	23/b	shkurre	31	"	"	"	
9	40	"	Manajthi	25	shkurre	24	"	"	"	
10	41	"	Perroi samarit	26	shkurre	25	"	"	"	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Ruzhdie

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
29, 31-35, 37 -38, 40-41	Pyll, inproduktive	Në pronësi